Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/060-34788
Më 12.03.2019

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas propozimit të Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, kryetari i Komunës, mori këtë:

VENDIM

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejimin e lyerjes së brendshme të objekteve shkollore të Komunës së Prizrenit, sipas planifikimit, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.

2. Ky projekt realizohet sipas kodit të planifikuar buxhetor të Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës nr. 89677.

3. Obligohet Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Mytaher Haskuka

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës,
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Sektorit të Prokurimit,
- Arkivës së Kryetarit.